



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

FOL

BIARN
BALKAN
INVESTIGATIVE
REPORTING
NETWORK | KOSOVO

**PROGRAMI PËR FUQIZIMIN
E SISTEMIT TË DREJTËSISË
RAPORTI MBI MONITORIMIN
E PUBLIKIMIT TË AKTGJYKIMEVE**

**PROGRAMI PËR FUQIZIMIN
E SISTEMIT TË DREJTËSISË
RAPORTI MBI MONITORIMIN
E PUBLIKIMIT TË AKTGJYKIMEVE**

Janar 2020

Titulli: Raporti mbi monitorimin e publikimit të aktgjyqimeve

Autore: Nora Bajrami

Ndihmuan: Yllka Buzhala dhe Albana Hasani

Viti i botimit: Janar 2020

Dizajni dhe shtypi: Envinion

Publikuar nga:

Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35

Prishtina 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org

+386 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2019. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Ky raport është realizuar me përkrahjen e popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Lëvizjes FOL dhe jo domosdoshmërisht reflekton këndvështrimet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar apo Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
HYRJE	9
METODOLOGJIA.....	10
PUBLIKIMI I AKTGJYKIMEVE – BAZA LIGJORE	11
Publikimi i aktgjykimeve gjatë periudhës janar 2016 – prill 2019.....	11
GJETJET NGA MONITORIMI I PUBLIKIMIT TË AKTGJYKIMEVE	14
Gjykata Supreme	15
Gjykata e Apelit.....	18
Gjykata Themelore e Prishtinës	21
Gjykata Themelore e Ferizajt.....	24
Gjykata Themelore e Mitrovicës	27
Gjykata Themelore e Prizrenit.....	30
Gjykata Themelore e Gjakovës	33
Gjykata Themelore e Pejës.....	36
Gjykata Themelore e Gjilanit.....	39
REKOMANDIME.....	42
BURIMET	44

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Lëvizja FOL me mbështetjen e Programit të USAID-it për Fuqizim të Sistemit të Drejtësisë (USAID/JSSP) dhe në partneritet me BIRN Kosova, janë duke e zbatuar projektin “Kërkimi i Transparencës në Sistemin Gjyqësor të Kosovës”. Në bashkëpunim të ngushtë me USAID/JSSP, përmes këtij projekti FOL dhe BIRN synojnë të përmirësojnë efikasitetin, transparencën, përgjegjshmërinë dhe rritjen e besimit publik në sistemin gjyqësor.

Raporti “Monitorimi i Publikimit të Aktgjykimeve” përfshinë gjetjet nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve në ueb-faqen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës prej datës 01 maj deri me 15 nëntor 2019.

Publikimi i aktgjykimeve, përveç ndikimit në raport me qytetarët, ndikon në rritjen e sigurisë juridike, duke i njoftuar palët me mënyrën se si gjykatat veprojnë në raste që kanë karakteristika të njëjta me palët e interesuara. Për më tepër, publikimi i aktgjykimeve kufizon arbitraritetin dhe simulon të gjitha palët, duke mos përjashtuar gjyqtarët, që të argumentojnë rastet sa më mirë. Përveç dobive që ky proces ka në raport me studentët, dhe studiuesit duke u ndihmuar për të kuptuar më mirë llojin e vendimmarrjes dhe atë duke studiuar raste konkrete, publikimi i aktgjykimeve ndihmon drejtpërdrejt në rritjen e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor.

Qëllimi i këtij raporti është që të vlerësoj shkallën e përmbushjes së obligimit ligjor të publikimit të aktgjykimeve nga gjykatat e të gjitha niveleve. Nëpërmjet publikimit të kategorive të ndryshme të të dhënave në lidhje me procesin e publikimit të aktgjykimeve ky raport synon që të ndihmoj dhe promovoj përmirësimin e transparencës dhe qasjes së qytetarëve, dhe palëve tjera të interesuara, në informata të cilat ndihmojnë që këta të fundit të kuptojnë, nga afër, mënyrën dhe përmbajtjen e vendimmarrjes së gjykatave.

Ky raport përmban të dhëna të cilat tregojnë numrin e përgjithshëm të aktgjykimeve të publikuara nga gjykatat e Kosovës, identifikon problemet dhe sfidat në publikimin e aktgjykimeve, si dhe ofron një listë rekomandimesh për veprimet që organet gjyqësore duhet të ndërmarrin për të përmirësuar shkallën dhe dinamikën e publikimit të aktgjykimeve.

Si hap i parë, procesi i monitorimit ka eksploruar dhe vlerësuar shkallën e përputhshmërisë së aktgjykimeve të publikuara me kërkesat specifike të Ligjit për Gjykatat¹, Udhëzimit Administrativ për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve të Plotfuqishme², si dhe Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve.³

Së dyti, monitorimi i publikimit të aktgjykimeve ka përcjell dhe ka mbledhur të dhëna mbi numrin e aktgjykimeve të publikuara si dhe të dinamikës së publikimit të tyre nga gjykatat. Që nga fillimi i monitorimit kemi vërejtur një rritje të vazhdueshme të publikimit të aktgjykimeve nga shtatë gjykatat themelore (bashkë me degët e tyre), Gjykata e Apelit, dhe Gjykata Supreme. Në lidhje me këtë të fundit, gjetjet në vijim reflektojnë disa nga karakteristikat e përgjithshme të këtij procesi.

- Përgjatë periudhës monitoruese 1 maj-15 nëntor 2019, gjykatat kanë publikuar 6,611 aktgjykime, rreth 1,000 aktgjykime për muaj. Krahasuar me periudhën kohore janar 2016 deri më prill 2019 në të cilat gjykatat në total kanë publikuar 10,091 aktgjykime (përgjatë tri viteve), apo rreth 250 aktgjykime për muaj.

1 Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Gjykatat. Dhjetor 2018.

2 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve të Plotfuqishme.

3 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Shabllonet Standarde të aktgjykimeve (2019).

- Numri i gjyqtarëve që kanë aktgjykime të publikuara është rritur për rreth 75%. Përderisa në muajin maj 2019, vetëm 91 gjyqtarë kanë publikuar aktgjykime, në nëntor 2019 numri i gjyqtarëve që kanë publikuar aktgjykime ka arritur në 159 gjyqtarë.
- Tri gjykatat me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë periudhës monitoruese janë Gjykata Themelore e Ferizajt me 1,245 aktgjykime të publikuara; Gjykata e Apelit me 1,176, si dhe Gjykata e Prizrenit me 1,056 aktgjykime.
- Gjykata Themelore e Mitrovicës (nga 0 në 715) dhe ajo e Gjakovës (nga 16 në 707) kanë shënuar rritje të vazhdueshme në publikimin e aktgjykimeve gjatë periudhës së monitorimit. Gjykata Supreme (314), Gjykata Themelore e Prishtinës (674), Gjykata Themelore e Pejës (504) dhe Gjykata Themelore e Gjilanit (221) kanë publikuar më pak aktgjykime krahasuar me gjykatat e tjera.
- Degët e gjykatave me më së shumti aktgjykime të publikuara janë: dega e Kaçanikut me 215 aktgjykime të publikuara, dega e Istogut ka publikuar 172 aktgjykime, si dhe dega e Leposaviqit 145 sosh.
- Prej 6,611 aktgjykimeve të publikuara në periudhën kohore 1 maj 2019 deri më 15 nëntor 2019, 68% janë aktgjykime penale; 28% janë civile; 25% janë administrative, dhe 2% janë ekonomike.
- Prej aktgjykimeve të publikuara, vetëm 60 aktgjykime janë aktgjykime në raste të korrupsionit; 52 të dhunës në familje, si dhe 21 raste të krimit të organizuar.
- Prej 6,611 aktgjykimeve të publikuara gjatë periudhës monitoruese, gjykatat kanë vënë në përdorim shabllonin e aktgjykimeve në 3,856 aktgjykime, apo vetëm në 42% të aktgjykimeve të publikuara.
- Prej 6,611 aktgjykimeve, 91% janë publikuar në gjuhën shqipe, ndërsa 9% në gjuhën serbe.
- Në total vetëm 54 aktgjykime kanë qenë të pa-anonimizuara. Në tetor dhe nëntor ky numër ka rënë në 0.
- Gjykatave mesatarisht, i'u janë dashur 125 ditë kohë për të publikuar një aktgjykim, apo më shumë se dyfishi i kohës së paraparë me ligjin për publikimin e aktgjykimeve (i cili parasheh 60 ditë kohë për të publikuar aktgjykimet). Si rezultat i monitorimit të FOL dhe BIRN, Këshilli Gjyqësor i Kosovës filloi të raportoj publikisht rreth numrit të publikimit të aktgjykimeve nga ana e gjykatave të Kosovës.

Përveç monitorimit të aktgjytimeve, FOL ka vizituar Gjykatën Supreme, Gjykatën e Apelit si dhe shtatë gjykatat themelore, ku ka intervistuar zyrtarët përgjegjës për publikimin e këtyre aktgjytimeve. Bazuar në këto vizita monitoruese problemet kryesore me të cilat ballafaqohen gjykatat, të cilat janë ndarë me monitoruesit tanë janë:

- Mungesa e stafit përgjegjës për publikimin e aktgjytimeve.
- Mungesa e bashkëpunëtorëve profesional, të cilët janë zyrtarët përgjegjës për anonimizimin e aktgjytimeve.
- Në disa gjykata, mungesa e zyrtarëve për informim, të cilat nuk i kanë caktuar ende.
- Probleme teknike sidomos në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, ku degët si Leposaviqi dhe Zubin Potoku nuk kanë qasje në internet.
- Mos-njoftimi i stafit përgjegjës për vendimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në lidhje me publikimin e aktgjytimeve.

HYRJE

Raporti “Monitorimi i publikimit të aktgjykimeve” ka për qëllim të paraqes gjendjen aktuale të publikimit të aktgjykimeve. Po ashtu përmes këtij raporti synojmë të rrisim transparencën, llogaridhënien dhe efikasitetin në punën e gjykatave.

Ky raport ofron një pasqyrë të qartë të gjendjes dhe dinamikës së publikimit të aktgjykimeve. Ndër të tjera, raporti identifikon mangësitë në respektimin e Ligji për Gjykatat,⁴ Udhëzimit Administrativ për Anonimizimin e Aktgjykimeve⁵ dhe Vendimin për Standardizimin e Aktgjykimeve,⁶ Raporti, ndër të tjera përmban të dhëna mbi llojin e lëndëve nga të cilat gjykatat publikojnë më shumë aktgjykime, si dhe përmban tregues të veçantë për gjyqtarët më aktiv në këtë publikimin e aktgjykimeve.

PROGRAMI PËR FUQIZIM TË SISTEMIT TË DREJTËSISË I USAID është një aktivitet pesë vjeçar i sundimit të ligjit në Kosovë si vazhdimësi e përpjekjeve të mëhershme të USAID për të avancuar sundimin e ligjit në Kosovë dhe të siguroj që sistemi i drejtësisë operon në mënyrë profesionale, efikase dhe llogaridhënëse. Programi fokusohet në promovimin e sistemit të drejtësisë bazuar në standardet më të larta të pavarësisë, paanësisë, integritetit, llogaridhënies, transparencës dhe në mbështetje të funksionimit dhe integritetit të strukturave gjyqësore në komunat në veri. Fuqizimi i efikasitetit dhe efektshmërisë në administrimin e gjyqësorit dhe ofrimit të shërbimeve cilësore. Përmes USAID, Programi për Fuqizim të Sistemit të Drejtësisë ndihmon Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe gjykatat në konsolidimin e rezultateve, në efektshmerinë, dhe menaxhimin e tyre.

LËVIZJA FOL ËSHTË ORGANIZATË JO-QEVERITARE e përkushtuar që të kontribuojë për qeverisje të mirë, parandalim dhe luftim të korrupsionit përmes mbështetjes dhe promovimit të qytetarisë aktive, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike. Përmes hulumtimit të politikave, avokimit, dhe mbështetjes teknike institucionale dhe monitorimit të institucioneve publike FOL rrit presionin publik mbi vendimmarrësit për të zvogëluar abuzimin e pushtetit. Përveç forcimit të transparencës dhe llogaridhënies së organeve vendimmarrëse dhe zyrtarëve publik, FOL punon për të hapur kanale të reja të komunikimit në mes të qeverisë dhe qytetarëve për të zvogëluar apatinë qytetare.

BIRN KOSOVA ËSHTË ORGANIZATË E PAVARUR JOQEVERITARE, qëllimi kryesor i së cilës është të kontribuojë për një proces të suksesshëm demokratik, përfshirë reformat në sistemin e drejtësisë. Për ta bërë këtë, BIRN krijoi një platformë të njohur online anti-korrupsion, prodhoi dhe transmetoi debate televizive, hetime terreni dhe raporte me ndikim analitik.

4 Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Gjykatat. Dhjetor 2018.

5 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve të Plotëfuqishme.

6 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Shabllonet Standarde të aktgjykimeve (2019).

METODOLOGJIA

Lëvizja FOL ka përdorë metodën e monitorimit të vazhdueshëm, pra monitorimin ditor të ueb portalit të KGJK-së. Paraprakisht, të gjitha gjykatat janë informuar përmes postës elektronike se ato do jenë subjekt i monitorimit për numrin dhe dinamikën e publikimit të aktgjytimeve, si dhe nëse publikimi i aktgjytimeve ndjek kërkesat e veçanta të ligjit, udhëzimit dhe vendimeve relevante. Të dhënat e mbledhura nga procesi i monitorimit janë paraqitur në formë infografikash, të cilat, shoqëruar me artikuj të shkurtër, janë publikuar çdo muaj në faqen e internetit dhe mediave sociale të Lëvizjes FOL, si dhe në platformën Kallxo.com.⁷

Lëvizja FOL fillimisht ka mbledhur të dhëna për numrin e aktgjytimeve të publikuara të nga të gjitha gjykatat, duke përfshirë edhe degët e tyre. Faza e mbledhjes së të dhënave është ndarë në dy pjesë: (1) Aktgjykimet e publikuara me Ligjin e vjetër për Gjykata 01 janar 2016 – 31 dhjetor 2018, dhe (2) Aktgjykimet e publikuara me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Gjykatat 01 janar 2019 – 30 prill 2019.

Nga aktgjykimet e publikuara Lëvizja FOL ka krijuar një databazë e cila, ndër të tjera përmban:

- Numrin e aktgjytimeve të publikuara nga çdo gjykatë, për çdo muaj;
- Respektimi i protokolleve dhe afateve të përcaktuara për publikimin e vendimeve si dhe pajtueshmëria e aktgjytimeve të publikuara me Ligjin për gjykatat dhe Udhëzimet Administrative;
- Mbrojtja e të dhënave personale të palëve dhe specifikat tjera të cilat rregullohen me ligj dhe akte tjera.
- Pasqyrimi i numrit total të të gjitha aktgjytimeve të publikuara nga Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, si dhe Gjykatat Themelore të Kosovës, duke mos përfshirë degët e tyre;
- Pasqyrimi i numrit total të aktgjytimeve të publikuara sipas gjyqtarëve;
- Niveli i zbatimit të Shabllonit Standard të Aktgjytimeve.
- Gjuha në të cilën janë publikuar aktgjytimeve, si dhe
- Llojin e lëndëve për të cilat ka më shumë aktgjytime të publikuara.

Për të identifikuar dhe ndihmuar në adresimin e mangësive në procesin e publikimit në ueb portalin e KGJK-së, Lëvizja FOL, ndër të tjera, ka zhvilluar vizita në gjykata, si dhe intervista me stafin e ngarkuar nga ana e gjykatave për publikim të aktgjytimeve. Të dhënat e mbledhura nga intervistat dhe vizitat në Gjykata janë përdorur në këtë raport për të identifikuar praktikatat e mira që gjykatat ndjekin për publikimin e aktgjytimeve si dhe për të njohur nevojat e stafit aktual të angazhuar në këtë proces.

⁷ Publikimi i aktgjytimeve nga të gjitha gjykatat e Kosovës në muajin korrik (2019). <https://kallxo.com/ligji/gjykata/publikimi-i-aktgjytimeve-nga-te-gjitha-gjykatat-e-kosoves-ne-muajin-korrik/>

PUBLIKIMI I AKTGJYKIMEVE – BAZA LIGJORE

Parimi i gjykimeve publike, pra gjykimit me dyer të hapura, pashmangshëm nënkupton edhe detyrim të gjykatave për të publikuar verdiktin apo aktgjykimin. Ky parim është inkorporuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në nenin 31 të Kushtetutës përcaktohet se gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata në rrethana të veçanta konsideron se në të mirë të drejtësisë është i domosdoshëm përjashtimi i publikut.⁸

Ky standard juridik natyrisht ka burimin e vet edhe tek konventat ndërkombëtare. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 6, paragrafi 1, përcakton se aktgjykimet (vendimet e gjykatave) duhet të shpallen publikisht.⁹

Ligji për Gjykatat, i miratuar në dhjetor të vitit 2018, ka obliguar të gjitha gjykatat që të publikojnë të gjitha aktgjykimet brenda një afati prej 60 ditësh në faqet e tyre të internetit. Kjo është paraparë në paragrafin 3 të nenit 6 të këtij Ligji.¹⁰ Krahas kësaj, Këshilli Gjyqësor i Kosovës me qëllim të zbatimit të Ligjit për Gjykata, ka themeluar grupin punues për hartimin e Udhëzimit të ri Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara dhe Manualin për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara.

Në raport me çështjen e mbrojtjes së të dhënave personale gjatë publikimit të aktgjykimeve, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në vitin 2016 ka nxjerrë një Udhëzim Administrativ për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve të Plotfuqishme nga Gjykatat e Kosovës.¹¹ Ky udhëzim përcakton rregullat për anonimizimin e aktgjykimeve para publikimit të tyre nëpër ueb faqet e internetit. Pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, të dhënat personale të palëve të përfshira në procese gjyqësore (si emri, mbiemri, adresa, data dhe vendi i lindjes, numri i letërnjoftimit apo pasaportës, patentë-shoferi apo tabelat e regjistrimit të automjetit, apo numri i ndonjë dokumenti tjetër personal i palës) duhej të anonimizoheshin.¹²

Përgjegjës për çështjen e anonimizimit të aktgjykimeve, sipas këtij udhëzimi, është bashkëpunëtori profesional në secilën gjykatë dhe degë të saj, i caktuar nga kryetari i gjykatës përkatëse.

Sipas nenit 6 të këtij udhëzimi, bashkëpunëtori profesional e përcjell aktgjykimin e anonimizuar tek zyrtari për informim publik pranë gjykatës apo stafit tjetër të autorizuar të gjykatës për ta vendosur atë në ueb-faqen e gjykatës. Po ashtu nga ky udhëzim kërkohet që aktgjykimet të vendosen në ueb-faqe në formatin PDF.¹³ Tani, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është duke punuar në Udhëzimin e ri Administrativ për Publikim të Aktgjykimeve, i cili do të jetë në përputhje me ligjin e ri në fjalë.

PUBLIKIMI I AKTGJYKIMEVE GJATË PERIUdhËS JANAR 2016 – PRILL 2019

Meqë publikimi i vendimeve gjyqësore ka filluar të rregullohet me ligj qysh në vitin 2016, Lëvizja FOL ka bërë një skenim të gjendjes së publikimit të aktgjykimeve për periudhën sa ka qenë në fuqi Ligji (i vjetër) për Gjykatat, e i cili i ka obliguar gjykatat që të publikojnë vetëm aktgjykimet e plotfuqishme në faqet e tyre zyrtare.

8 Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Prill 2008.

9 Këshilli i Evropës. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Tetor 2013.

10 Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Gjykatat. Dhjetor 2018.

11 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve të Plotëfuqishme.

12 Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Udhëzimi administrativ (02/2016) për anonimizimin dhe publikimin e aktgjykimeve të plotëfuqishme. Shkurt 2016.

13 Ibid.

Ashtu siç mund të shihet në tabelën e poshtëshënuar, Gjykatat e Kosovës, përgjatë periudhës tri vjeçare, kanë publikuar gjithsej 10,091 aktgjykime (gjegjësisht janar 2016 – prill 2019). Gjykata Themelore e Prizrenit, në këtë periudhë kohore ka prirë me publikimin e aktgjykimeve, e pasuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës dhe ajo e Ferizajt.

Publikimi i aktgjykimeve janar 2016 - 30 prill 2019	2016	2017	2018	30 prill 2019
Gjykata Supreme	77	54	272	219
Gjykata e Apelit	67	376	521	224
Gjykata Themelore Prishtinë	68	508	1,110	200
Gjykata Themelore Ferizaj	125	657	650	55
Gjykata Themelore Prizren	102	223	1,291	232
Gjykata Themelore Gjakovë	18	264	444	278
Gjykata Themelore Pejë	7	131	198	37
Gjykata Themelore Mitrovicë	0	8	604	120
Gjykata Themelore Gjilan	169	448	330	4
Totali për gjykatë	633	2,669	5,420	1,369

Totali i përgjithshëm 10,091

TABELA I: Të dhënat me publikimet e aktgjykimeve nga secila gjykatë për vitet 2016, 2017 dhe 2018 deri 30 prill 2019

Me Ligjin (e ri) për Gjykatat, nga muaji janar i vitit 2019 gjykatat janë të obliguara të publikojnë të gjitha aktgjykimet në faqen e tyre zyrtare të internetit, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit, pavarësisht plotfuqishmërisë së tyre.

Lëvizja FOL para se të filloj monitorimin mujor nga muaji maj, fillimisht ka bërë vlerësimin e gjendjes së publikimit të aktgjykimeve sipas ligjit në fjalë. Gjykatat nga 1 Janari 2019 deri me 30 Prill 2019, kanë publikuar gjithsej 1,369 aktgjykime, numër ky relativisht i ulët krahasuar me gjendjen aktuale të publikimit të tyre.

Gjatë periudhës monitoruese (01 maj – 15 nëntor), gjykatat bashkë me degët e tyre kanë publikuar 80% më shumë aktgjykime, përkatësisht 6,611 aktgjykime. Këto të dhëna mund të krahasoheshin me vitin 2018, periudhën e njëjtë, mirëpo për shkak të ndryshimit të kornizës ligjore ky krahasim do të ishte i padrejtë. Korniza e vjetër ligjore obligonte gjykatat të publikojnë aktgjykimet e plotfuqishme, ndërsa Ligji (i ri) për Gjykatat, kërkon që të publikohen të gjitha llojet e aktgjykimeve, pavarësisht plotfuqishmërisë së tyre ligjore.




FIGURA 1: Pasqyra e publikimit të aktgjyimeve gjatë vitit 2019

Në grafikonin e më-poshtëm mund të gjeni një pasqyrë të saktë të publikimit të aktgjyimeve nga të gjitha gjykatat e Kosovës, bashkë me degët e tyre.




FIGURA 2: Të dhënat me publikimet e aktgjyimeve për secilën gjykatë për secilin muaj nga fillimi i monitorimit

GJETJET NGA MONITORIMI I PUBLIKIMIT TË AKTGJYKIMEVE

Para se të japim vlerësimet mbi procesin e monitorimit, duhet sqaruar që nga muaj prill 2019, ueb-portali i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe gjykatave u jep mundësinë të gjitha palëve të interesuara që të japin komente në draft dokumente përmes konsultimeve publike, si dhe të informohen mbi një numër të dhënash që lidhen me këshillin, gjykatat dhe statistikat. Ndër të tjera, publikimi i aktgjykimeve në ueb portalin e gjykatave, mbetet elementi më domethënës në gjithë këtë proces. Përveç që ka kontribuar në rritjen e transparencës së gjykatave, publikimi i aktgjykimeve njëkohësisht ka rrit njohuritë juridike dhe ndërgjegjësimin e publikut për punën e gjykatave. Po ashtu, një gjë e tillë ndihmon edhe në krijimin e debatit publik për çështje të rëndësishme sociale dhe juridike.

Monitorimi i kryer nga Lëvizja FOL ka gjetur parregullsi teknike të shumta, të cilat janë bërë gjatë publikimit të tyre. Ajo që më së shumti vihet në pah, ka qenë publikimi i të njëjtit aktgjykim disa herë. Gjatë procesit të monitorimit, kemi hasur raste në të cilat i njëjti aktgjykim është publikuar deri në katër (4) herë, në të njëjtën gjykatë, dhe në të njëjtin muaj. Në shumë raste kemi hasur në publikim të aktvendimeve, në vend të aktgjykimeve. Legjislacioni në fuqi nuk e parashih publikimin e aktvendimeve dhe atë për shkak se numri i nxjerrjes së tyre gjatë proceseve gjyqësore është i shumtë.

Gjatë monitorimit po ashtu janë vërejtur lëshime sa i përket datës së shpalljes së aktgjykimit, si dhe datës së publikimit të tij. P.sh. pas hapjes së aktgjykimit, kemi vërejtur se ky i fundit ka pasur datë tjetër të shpalljes në ueb portal nga ai që është shënuar brenda aktgjykimit.

Sa i përket anonimizimit të aktgjykimeve, zyrtarët përgjegjës për publikimin e tyre në përgjithësi kanë qenë të vëmendshëm pasi që nga 6,611 aktgjykime të publikuara vetëm 154 (2%) kanë qenë të pa-anonimizuara. Aktgjykimet e pa-anonimizuara kanë qenë më evidente në Gjykatën Themelore të Prizrenit, në Gjykatën e Apelit si dhe atë Supreme.

Po ashtu, gjatë monitorimit kemi hasur në aktgjykime të publikuara në formatin word, e jo te kthyer në PDF, sipas kërkesës së Udhëzimit Administrativ për Anonimizimin e Aktgjykimeve. Gjatë monitorimit, kemi identifikuar edhe aktgjykime të zbrazëta. Lëshimet teknike janë bërë edhe tek gjuha e publikimit të aktgjykimeve. P.sh. gjatë procesit të monitorimit kemi identifikuar aktgjykime të gjuhës shqipe, të publikuara në versionin e gjuhës serbe dhe anasjelltas.

Një problem tjetër i shprehur ka qenë edhe publikimi i aktgjykimeve me përmbajtte të ndryshme por me numër identik të rastit. Sa i përket një lloj unifikimi teknik/standard të një aktgjykimi, mund të themi se një pjesë e aktgjykimeve kanë qenë të shkruara duke përdorur standarde të ndryshme nga njëra tjetra, varësisht nga gjyqtari, i cili e ka përpiluar aktgjykimin. Dallime janë vërejtur nga vendosja e emblemës së Republikës së Kosovës apo e Këshillit deri të vendosja e numrit të rastit tek data e shpalljes së aktgjykimit.

Një e gjetur tjetër nga procesi i monitorimit dhe gjatë vizitave në terren, është një shprehje zëngjirëse mes vendimeve, të cilat i merr Këshilli dhe sa zbatohen ato nga ana e gjykatave. Shumica e zyrtarëve përgjegjës për publikim të aktgjykimeve kanë deklaruar se nuk kanë qenë të njoftuar me Ligjin (e ri) për Gjykatën, i cili i obligon ato të publikojnë aktgjykimet të cilat nuk janë të plotfuqishme.

GJYKATA SUPREME

Gjykata Supreme, përfshirë Kolegjin e Apelit si dhe Dhomën e Posaçme, gjatë periudhës monitoruese (1 maj – 15 nëntor 2019) ka publikuar gjithsej 314 aktgjykime.

Publikimit i aktgjykimeve në këtë gjykatë ka arritur në shifrat maksimale në muajin korrik, ku janë publikuar 114 aktgjykime. Fatkeqësisht, I njëjti standard nuk aplikohet gjatë gushtit dhe shtatorit.

Në grafikën e më poshtme mund të shohim trendin e publikimit të aktgjykimeve nga kjo gjykatë të ndarë në muaj.




FIGURA 3: Statistikat e përgjithshme të aktgjykimeve në Gjykatën Supreme

Dhoma e Posaçme dhe Kolegji i Apelit bashkë kanë publikuar 45 aktgjykime.

Grafika e mëposhtme tregon dinamikën e publikimit të aktgjykimeve përgjatë muajve monitorues.




FIGURA 4: Publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Supreme

Nga monitorimi duket qartazi që Gjykata Supreme ka publikuar më shumë aktgjykime nga lëndët civile dhe më pak të natyrave tjera, si ato penale, administrative dhe ekonomike.

Në tabelën në vijim tregon ndarjen e aktgjykimeve të publikuara sipas llojit të lëndëve:

Natyra e lëndëve	Penale	Civile	Administrative	Ekonomike
Gjykata Supreme	97	132	71	14

Total 314

TABELA 2: Ndarja e aktgjykimeve sipas natyrës së veprës

Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve, Gjykata Supreme në periudhën monitoruese ka publikuar vetëm 1 aktgjykim për rastet e korrupsionit, 3 aktgjykime për rastet e krimit të organizuar dhe vetëm 1 nga rastet e dhunës gjinore.

Sa i përket zbatimit të Shabllonit Standard të Aktgjykimeve, Gjykata Supreme nuk e ka zbatuar në nivelin e duhur vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Nga 314 aktgjykime të publikuara vetëm 36 janë të publikuara në formë standarde sipas kërkesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Grafika e mëposhtme tregon përdorimin e Shabllonit Standard të Aktgjykimeve nga ana e gjykatësve të Gjykatës Supreme.




FIGURA 5. Përdorimi i Shabllonit në aktgjykime

Sa i përket respektimit të Udhëzimit Administrativ për Anonimizimin e Aktgjykimeve, Gjykata Supreme nga 314 aktgjykime të publikuara, vetëm 17 prej tyre janë të pa-anonizuara.

Nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 130 ditë për të publikuar një aktgjykim. Pra, në mesatare, tendenca e Gjykatës Supreme është që të publikoj aktgjykimet jashtë afatit të përcaktuar me ligj. Por koha mesatare e publikimit të aktgjykimeve nga ana e Gjykatës Supreme është duke u përmirësuar dukshëm në krahasim me muajt fillestarë të monitorimit.

Lëvizja FOL gjithashtu ka monitoruar publikimin e aktgjykimeve nga gjyqtarët. Nga ky monitorim kemi listuar 5 gjyqtarët e Gjykatës Supreme të cilët kanë publikuar më së shumti aktgjykime gjatë periudhës monitoruese. Grafika në vijim tregon listën e gjyqtarëve në fjalë:




FIGURA 6. Pasqyra e gjyqtarëve me më shumë publikime në Gjykatën Supreme

GJYKATA E APELIT

Gjykata e Apelit është gjykatat e dytë me numrin më të madh të publikimit të aktgjykimeve gjatë periudhës monitoruese. Kjo gjykatë ka publikuar gjithsej 1,176 aktgjykime.

Në grafikën në vijim ne paraqesim trendin publikimit të aktgjykimeve ndër muaj (pra nga muaji maj deri në mesin e muajit nëntor).




FIGURA 7. Statistikat e përgjithshme të aktgjykimeve në Gjykatën e Apelit

Divizioni i Mitrovicës ka publikuar vetëm 10 aktgjykime gjatë periudhës së lartshënuar. Në grafikën poshtë mund të përcjellim trendin e publikimeve të aktgjykimeve të ndarë në muaj.




FIGURA 8. Publikimi i aktgjykimeve nga dega e Gjykatës së Apelit

Sa i përket natyrës së lëndëve, edhe gjykata e Apelit ka të publikuara më shumë aktgjykime të lëndëve të natyrës civile. Nga totali i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara, 783 prej tyre janë të natyrës civile.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihet publikimi i aktgjykimeve të kësaj gjykate, të ndarë sipas llojit të lëndëve.

Natyra e lëndëve	Penale	Civile	Ekonomike	Administrative
Gjykata e Apelit	294	783	41	58
Totali 1,176				

TABELA 3: Ndarja e aktgjykimeve sipas natyrës së veprës

Nga 294 aktgjykime të natyrës penale, Apeli ka publikuar 20 aktgjykime të natyrës së korrupsionit, 6 të natyrës me bazë dhunën gjinore, si dhe 4 nga lëndët e krimit të organizuar.

Sa i përket aplikimit të formave standarde për përpilimin e aktgjykimeve (aplikimit të Shabllonit për Standardizim të Aktgjykimeve), Apeli (bashkë me Divizionin e Apelit të Mitrovicës), nga 1,176 aktgjykime të publikuar nuk publikuar asnjë aktgjykim duke vënë në përdorim formën e standardizuar. Gjatë vizitës sonë në këtë gjykatë dhe gjatë intervistimit, hulumtuesit tanë janë informuar se kjo gjykatë as që është e informuar për një vendim të tillë të Këshillit Gjyqësor.¹⁴ Mirëpo, sipas dhënave të prezantuara nga Sekretari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës vendimi i KGJK-së i është dërguar çdo kryetari të gjykatës.





FIGURA 9. Përdorimi i Shabllonit në aktgjykime

¹⁴ Intervistë me Arbër Jasharin, Bashkëpunëtorë Profesional / Zyrtarë për Informim në Gjykatën e Apelit. Realizimi i intervistes: 14.10.2019

Për çështjen e mbrojtjes së të dhënave personale, respektivisht anonimizimin e tyre, Gjykata e Apelit ka treguar kujdes të shtuar. Nga 1,176 aktgjykime të publikuara nga kjo gjykatë, vetëm 18 nga to janë publikuar të pa-anonimizuara. Duke pasur parasysh që në këtë gjykatë ka mungesë të bashkëpunëtorëve profesional, si dhe zyrtarit/es për informim dhe numrin relativisht të madh të aktgjykimeve të publikuara, rezultati i gabimeve në anonimizim mbetet i kuptueshëm.

Një gjetje e veçantë e këtij raporti është që Gjykata e Apelit ka respektuar në tërësi afatin ligjor për publikim të aktgjykimeve. Kjo gjykatë, ka publikuar aktgjykimet mesatarisht brenda 54. Në lidhje me respektimin e afatit ligjor, Gjykata e Apelit qëndron më së miri nga gjitha gjykatat.

Gjyqtarët më aktiv në procesin e publikimit të aktgjykimeve të kësaj gjykate janë dhënë në tabelën e mëposhtme.



Gjyqtarët me më së shumti publikime në Gjykatën e Apelit

FIGURA 10. Pasqyra e gjyqtarëve me më shumë publikime në Gjykatën e Apelit

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Gjykata Themelore e Prishtinës është një prej gjykatave me më së shumti lëndë. Kjo gjykatë funksionon me 4 degë; dega në Podujevë; dega në Graçanicë; dega në Lipjan dhe dega në Glllogvc.

Po ashtu numri i madh i lëndëve në këtë Gjykatë reflekton faktin që kjo e fundit mbetet gjykata me kompetencë ekskluzive e shkallës së parë për të gjitha lëndët e natyrës ekonomike dhe administrative. Në raport me numri i aktgjykimeve të publikuara në këtë gjykatë, për më shumë se gjashtë muaj, është relativisht i vogël. Kjo gjykatë, gjatë periudhës monitoruese ka publikuar gjithsej 676 aktgjykime, dhe kjo bashkë me 4 (katër) degët e saj.

Në grafikën në vijim janë paraqitur të dhënat mbi numrin e aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Prishtinës përgjatë muajve monitorues.




FIGURA 11. Statistikat e përgjithshme të aktgjykimeve në Gjykatën Themelore të Prishtinës

Gjatë takimeve tona në këtë gjykatë, mungesa e stafit, e në veçanti e bashkëpunëtorëve profesional, si dhe ngarkesa me punë të shumta të zyrës për informim është dhënë si arsye për publikimin e një numri të vogël të aktgjykimeve.¹⁵

Publikimin e aktgjykimeve për secilën degë të GJTHPr, mund ta shohim në grafikën e mëposhtme.

¹⁵ Intervistë me Mirlinda Gashin, zyrtare për informim në Gjykatën Themelore Prishtinë. Realizimi i intervistës: 24.10.2019




FIGURA 12. Publikimi i aktgjyimeve nga degët e Gjykatës Themelore Prishtinë

Ligji për Gjykata ka paraparë që Gjykata Themelore e Prishtinës përveç rasteve penale dhe civile, është kompetente që të trajtoj me kompetence për të gjithë Kosovën të gjitha lëndët administrative dhe ekonomike.¹⁶

Në tabelën e mëposhtme mund të shohim se si ka performuar kjo gjykatë në publikimin e aktgjyimeve të ndarë në bazë të llojit të lëndëve.

Natyrë e lëndëve	Penale	Civile	Administrative	Ekonomike
Gjykata Themelore e Prishtinës	480	138	21	37

Totali 676

TABELA 4: Ndarja e aktgjyimeve sipas natyrës së veprës

Nga 480 aktgjyime të lëndëve të natyrës penale, 23 janë të veprave penale të korrupsionit, 3 janë me bazë në dhunë gjinore, si dhe 4 nga to janë lëndë të krimit të organizuar.

Në grafikën në vijim mund të vërejmë aplikimin e Shabllonit për Publikim të Aktgjyimeve nga gjyqtarët e kësaj gjykate.

¹⁶ Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Gjykatat. Dhjetor 2018.




FIGURA 13. Përdorimi i Shabllonit në aktgjykime

Gjykata Themelore e Prishtinës lë shumë për të dëshiruar për sa i përket respektimin të afatit ligjor për publikim të aktgjykimeve në ueb faqen e saj. Gjatë monitorimit kemi vërejtur se në këtë gjykatë mesatarja e ditëve për publikim të aktgjykimeve është mbi 160 ditë, llogaritur gjithmonë nga data e shpalljes së tyre.

Kurse, gjyqtarët më aktiv në këtë gjykatë, të cilët i kanë dhënë rëndësi më të madhe publikimit të aktgjykimeve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.




FIGURA 14. Pasqyra e gjyqtarëve me më shumë publikime në Gjykatën Themelore të Prishtinës

GJYKATA THEMELORE E FERIZAJT

Gjykata Themelore e Ferizajt nën ombrellën e saj i ka edhe dy degë, Kaçanikun dhe Shtërpcën. Kjo gjykatë renditet si gjykata më e suksesshme në lidhje me publikimin e aktgjykimeve gjatë periudhës sonë monitoruese. Kjo gjykatë ka të publikuara gjithsej 1,245 aktgjykime, numër ky relativisht i madh i publikimit duke pasur parasysh që edhe kjo gjykatë ballafaqohet me mungesë resursesh të stafit.

Në tabelën e më poshtme mund ta shihni trendin e publikimeve nga kjo gjykatë përgjatë muajve monitorues.




FIGURA 15. Statistikat e përgjithshme të aktgjykimeve në Gjykatën Themelore të Ferizajt

Një rol të rëndësishëm sa i përket rritjes së numrit nga Gjykata Themelore e Ferizajt e kanë edhe degët e kësaj gjykate. Vlen të theksohet dega e Kaçanikut, e cila është dega me më së shumti publikime, gjithsej 215.

Në tabelën e poshtme e vërejmë se sa publikime i kanë bërë degët, Kaçanikut dhe Shtërpca.




FIGURA 16. Publikimi i aktgjyimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Ferizajt

Gjatë intervistës sonë me zyrtarët të kësaj gjykate, kuptohet që kjo gjykatë ka arritur që të regjistroj të gjitha lëndët në SMIL, andaj edhe publikimi i tyre si proces është më i lehtë.¹⁷

Gjykata Themelore e Ferizajt, gjatë periudhës monitoruese ka publikuar aktgjyime të fushës penale dukshëm më shume se ato civile.

Tabela e më-poshtme tregon ndarjen e aktgjyimeve të publikuara sipas fushave të lartpërmendura.

Natyra e lëndëve	Penale	Civile
Gjykata Themelore e Ferizajt	1,066	179
Totali 1,245		

TABELA 5: Ndarja e aktgjyimeve sipas natyrës së veprës

Nga 1,066 vendime të gjykatës në fushën penale, 7 janë të evidentuara lëndë të korrupsionit, ndërsa 34 me bazë në dhunë gjinore.

Gjykata e Ferizajt bashkë me degët e saj është gjykata që më së shumti e ka aplikuar vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për sa i përket përdorimit të Shabllonit Standard të Aktgjyimeve.

¹⁷ Intervistë me Albenora Bekteshi – zyrtare për informim në Gjykatën Themelore të Ferizajt. Realizimi i intervistës: 15. 10 .2019.

Më poshtë mund të shihet se si është aplikuar në tërësi ky standard.




FIGURA 17. Përdorimi i Shabllonit në aktgjykime

Për çështjen e mbrojtjes së të dhënave personale, respektivisht anonimizimin e tyre gjatë periudhës monitoruese, Gjykata Themelore e Ferizajt nuk ka publikuar asnjë aktgjykim të pa-anonimizuar.

Sa i përket respektimit të afatit prej 60 ditësh për publikimin e aktgjykimeve në ueb-faqe, gjatë kësaj periudhe monitoruese është vërejtur se kësaj gjykate i është dashur mesatarisht 85 ditë për publikimin e tyre.

Kurse në tabelën e mëposhtme janë renditur pesë gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë periudhës së monitorimit.




FIGURA 18. Pasqyra e gjyqtarëve me më shumë publikime në Gjykatën Themelore të Ferizajt

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

Gjykata Themelore e Mitrovicës, përfshirë edhe katër degët e saj, Skenderajn, Vushtrrinë, Leposaviqin dhe Zubin Potokun gjatë periudhës 01 maj – 15 nëntor 2019 në ueb-faqe kanë publikuar gjithsej 715 aktgjykime. Gjykata Themelore e Mitrovicës është ndër gjykatat e cila pavarësisht se nuk ka publikuar asnjë aktgjykim në dy muajt e parë të fazës sonë të monitorimit, po e njëjta gjykatë në muajt tjerë ka publikuar një numër të konsiderueshëm të aktgjykimeve.

Këtë trend të ndryshimit pozitiv e vërejmë në grafikën e mëposhtme.




FIGURA 19. Statistikat e përgjithshme të aktgjykimeve në Gjykatën Themelore të Mitrovicës

Për të parë se si kanë performuar degët e gjykatës, grafika në vijim i pasqyron të ndara sipas muajve.




FIGURA 20. Publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës

Ashtu siç mund ta shohim më lart, degët nuk kanë publikuar asnjë aktgjykim për tre muaj rresht (qershor, korrik dhe gusht).

Pjesa më e madhe e këtyre aktgjytimeve të publikuara janë të natyrës penale. Në tabelën e më poshtëm mund të shihni pasqyrën e publikimit të këtyre aktgjytimeve të ndara sipas natyrës.

Natyra e lëndëve	Penale	Civile
Gjykata Themelore e Mitrovicës	561	154

Totali 715

TABELA 6: Ndarja e aktgjytimeve sipas natyrës së veprës

Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë kësaj kohe ka publikuar 3 lëndë të korrupsionit dhe 7 me bazë në dhunë gjinore.

Po ashtu edhe në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, gjatë periudhës monitoruese nuk kemi hasur në asnjë aktgjykim të pa - anonimizuar.

Sa i përket zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjytimeve, nga të gjitha aktgjykimet e publikuara nga kjo gjykatë dhe degët e saj, vetëm 309 kanë qenë në përputhshmëri me këtë vendim.

Në tabelën e mëposhtme, në mënyrë grafike mund të shihni trendin e zbatimit të këtij vendim.




FIGURA 21. Përdorimi i Shabllonit në aktgjytime

Në këtë gjykatë, mesatarja e ditëve për publikimin e aktgjykimeve në ueb-faqe pas shpalljes së tyre është 190 ditë, numër ky që dukshëm bie ndesh me afatin e përcaktuar me ligj.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihen pesë gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe në këtë gjykatë.




FIGURA 22. Pasqyra e gjyqtarëve me më shumë publikime në Gjykatën Themelore të Mitrovicës

Duhet të theksohen problemet teknike në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, ku degët si Leposaviqi dhe Zubin Potoku nuk kanë qasje në internet, andaj IT-ja i kësaj gjykate, obligohet t'i marr ato në formën elektronike dhe t'i sjellë në Gjykatën e Mitrovicës për publikim. Gjithashtu, IT është përgjegjës për publikimin e të gjitha aktgjykimeve, pavarësisht ngarkesës me punët tjera që i ka të parapara me kontratë.¹⁸

18 Intervistë me Ahmet Buzolli – IT në Gjykatën Themelore të Mitrovicës. Realizimi i intervistës: 1. 11. 2019.

GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT

Gjykata Themelore e Prizrenit gjatë periudhës monitoruese është vlerësuar si gjykata e tretë më e suksesshme për publikimin e aktgjytimeve. Gjatë kësaj periudhe kjo gjykatë ka publikuar gjithsej 1,054 aktgjykime.

Trendi i publikimit të aktgjytimeve për çdo muaj tregohet me grafikën në vijim, në të cilën vërehet që shtatori është muaji më i suksesshëm.



FIGURA 23. Statistikat e përgjithshme të aktgjytimeve në Gjykatën Themelore të Prizrenit

Degët si Dragashi dhe Suhareka, nuk është që kanë ndihmuar në rritjen e performancës së gjykatës, sa i përket publikimit të aktgjytimeve.




FIGURA 24. Publikimi i aktgjytimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Prizrenit

Në tabelën e mëposhtëm mund të shihet se Gjykata e Prizrenit ka publikuar dukshëm më shumë aktgjykime të natyrës penale.

Natyra e lëndëve	Penale	Civile
Gjykata Themelore e Prizrenit	891	163

Totali 1,054

TABELA 7: Ndarja e aktgjykimeve sipas natyrës së veprës

Nga 891, 3 janë identifikuar të natyrës së korrupsionit dhe 7 krim i organizuar.

Sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, kjo gjykatë nuk e ka respektuar në disa prej aktgjykimeve. Nga 1,054 aktgjykime të publikuara, 64 prej tyre janë të pa-anonimizuara.

Në grafikën e mëposhtme mund shihet niveli i aplikimit të Shabllonit për Publikim të Aktgjykimeve nga gjyqtarët e gjykatës së Prizrenit gjatë periudhës monitoruese.




FIGURA 25. Përdorimi i Shabllonit në aktgjykime

Nga monitorimi është vërejtur se Gjykatës së Prizrenit i duhet mesatarisht 90 ditë për publikim të aktgjykimeve në ueb-faqe.

Pesë gjyqtarët më aktiv të kësaj gjykate të cilët kanë publikuar më së shumti aktgjykime janë paraqitur në tabelën e poshtëshënuar.




FIGURA 26. Pasqyra e gjyqtarëve me më shumë publikime në Gjykatën Themelore të Prizrenit

Gjatë intervistës së zhvilluar me zyrtaren për informim në Gjykatën Themelore të Prizrenit janë evidentuar problematikat pothuajse të njëjta me Gjykatat tjera. Ndër problemet kryesore ishin mungesa e stafit, më specifikisht mungesa e bashkëpunëtorëve profesional si dhe e asistentes për informim. Gjithashtu personat përgjegjës për publikim të aktgjykimeve nuk kanë pasur qasje në editim të dokumenteve të publikuara në ueb faqe në rast se ato kanë qenë me gabime ose lëshime teknike. Personi përgjegjës për editim ose fshirje të aktgjykimeve nga ueb faqja ka qenë zyrtari i IT-së.¹⁹

¹⁹ Intervistë me Afërdita Kicaj – zyrtare për informim në Gjykatën Themelore Prizren. Realizimi i intervistës: 23.10.2019

GJYKATA THEMELORE E GJAKOVËS

Gjykata Themelore e Gjakovës, bashkë me degën e Rahovecit dhe Malishevës, në ueb-faqen zyrtare kanë publikuar gjithsej 704 aktgjykime.

Kjo gjykatë renditet e pesta për nga numri i aktgjykimeve të publikuara.




FIGURA 27. Statistikat e përgjithshme të aktgjykimeve në Gjykatën Themelore të Gjakovës

Degët nga kjo gjykatë kanë qenë kontribuuese në reflektimin e totalit të Gjakovës. Grafika më poshtë e pasqyron më saktë këtë gjendje.




FIGURA 28. Publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Gjakovës

Në tabelën e mëposhtme mund të shihet publikimi i aktgjykimeve sipas lëndëve të natyrës penale dhe civile në këtë gjykatë.

Natyra e lëndëve	Penale	Civile
Gjykata Themelore e Gjakovës	515	189
Totali 704		

TABELA 8: Ndarja e aktgjykimeve sipas llojit të lëndëve

Gjatë kësaj periudhe kjo gjykatë nuk ka publikuar asnjë aktgjykim të korrupsionit, për veprën penale dhunë me bazë gjinore ka publikuar 4 aktgjykime, ndërsa për krim të organizuar vetëm 1 aktgjykim.

Sa i përket anonimizimit të aktgjykimeve, ne kemi hasur në vetëm 14 aktgjykime të pa - anonimizuara, nga totali prej 704 aktgjykimesh.

Në raport me aplikimin e Shabllonit Standard për Publikim të Aktgjykimeve është e dukshme që gjyqtarët nga kjo gjykatë në përqindje të madhe i janë përmbajtur këtij parimi.




FIGURA 29. Përdorimi i Shabllonit në aktgjykime

Për shkak të problemeve teknike, të cilat janë bërë nga zyrtarët përgjegjës për publikimin e aktgjykimeve, e të cilat janë bërë në masë të madhe tek shpallja e aktgjykimeve, për ne ka qenë e pamundur të nxjerrim mesataren nga shpallja e aktgjykimit deri në publikim.

Pesë (5) gjyqtarët më aktiv sa i përket publikimit të aktgjykimeve në Gjykatën Themelore të Gjakovës janë paraqitur në grafikën e mëposhtme.




FIGURA 30. Pasqyra e gjyqtarëve me më shumë publikime në Gjykatën Themelore të Gjakovës

Nga intervista e realizuar me bashkëpunëtorin profesional në Gjykatën Themelore të Gjakovës që është përgjegjës për anonimizimin e aktgjytimeve kemi arritur të kuptojmë që kjo Gjykatë i merr aktgjykimet në forma klasike, përmes referentëve, pasi që jo të gjitha lëndët kanë qenë në SMIL. E gjithë kjo ka shkaktuar një zvarritje të procesit të publikimit të aktgjytimeve.²⁰

²⁰ Intervistë me Nëntor Oseku – bashkëpunëtor profesional në Gjykatën Themelore Gjakovë. Realizimi i intervistës: 28.10.2019

GJYKATA THEMELORE E PEJËS

Gjykata Themelore e Pejës, bashkë me degët e saj Deçanin, Istogun dhe Klinën është ndër gjykatat me më së paku aktgjykime të publikuara. Gjithsej kjo gjykatë gjatë periudhës monitoruese ka publikuar 504 aktgjykime. Gjatë takimit me zyrtares përgjegjëse për publikim të aktgjykimeve, mungesa e resurseve njerëzore ka ndikuar në performancë më të dobët të gjykatës së Pejës në publikimin e aktgjykimeve.²¹




FIGURA 31. Statistikat e përgjithshme të aktgjykimeve në Gjykatën Themelore të Pejës

Ashtu siç mund të vërehet në tabelën e lartë shënuar, GJTHPe ka shënuar rritje në muajt e fundit të monitorimit, ku nga 35 aktgjykime të publikuara në maj, në shtator dhe tetor janë publikuar 150, respektivisht 143. Dega e Deçanit nuk e ka të publikuar asnjë aktgjykim gjatë periudhës sonë monitoruese. Vlen të theksohet që është e vetmja degë pa asnjë aktgjykim të publikuar.

Në grafikën poshtë vërehet se degët e Gjykatës Themelore të Pejës për 4 muajt e parë të monitorimit i kanë publikuar vetëm 5 aktgjykime në total. Gjendje krejt ndryshe është gjatë tre muajve të fundit monitorues ku në veçanti vlen të theksohet dega e Istogut, e cila ka shënuar rritje të dukshme, saqë ka arrit të rendit vetën si dega e dytë me më së shumti publikime.

²¹ Intervistë me Tringa Zhuti – Zyrtare për Informim dhe monitorim të mediave. Realizimi i intervistës: 28.10.2019




FIGURA 32. Publikimi i aktgjytimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Pejës

Në tabelën e mëposhtëm mund të shihet lloji i aktgjytimeve të publikuara, ku shihet se, ka dyfish më shumë lëndë të natyrës penale.

Natyrë e lëndëve	Penale	Civile
Gjykata Themelore e Pejës	385	119
Totali 504		

TABELA 9: Ndarja e aktgjytimeve sipas natyrës së veprës

Nga të gjitha aktgjykimet e publikuara ne kemi evidentuar vetëm 1 aktgjykim të korrupsionit, 3 të veprës penale dhunë me bazë gjinore dhe 3 krim i organizuar.

Gjykata Themelore e Pejës, nga 504 aktgjytime të publikuara gjithsej vetëm 14 i ka publikuar të pa - anonimizuara.

Në grafikën në vijim vërejmë se nga 504 aktgjytime të publikuara, 199 janë publikuar në përputhje me Shabllonin e Aplikimit të Aktgjytimeve.





FIGURA 33. Përdorimi i Shabllonit në aktgjykime

Mesatarja e ditëve për publikim të aktgjykimeve nga kjo gjykatë është rreth 140 ditë, llogaritur nga data e shpalljes së aktgjykimit deri tek data e publikimit. Afati kohor prej 60 ditësh i paraparë me ligj nuk është respektuar në nivel të duhur nga kjo gjykatë.

Në grafikën e mëposhtme janë listuar pesë (5) gjyqtarët më aktiv në publikimin e aktgjykimeve në këtë gjykatë.



Gjyqtarët me më së shumti publikime

FIGURA 34. Pasqyra e gjyqtarëve me më shumë publikime në Gjykatën Themelore të Pejës

GJYKATA THEMELORE E GJILANIT

Gjykata Themelore e Gjilanit, bashkë me degën e Kamenicës, Vitisë e Novobërdës është gjykata me më së paku aktgjykime të publikuara gjatë periudhës monitoruese. Gjatë kësaj periudhe kjo gjykatë ka publikuar gjithsej 221 aktgjykime, të cilat janë publikuar kryesisht vetëm në muajt e fundit të monitorimit.

Ashtu siç mund të shihet tabela në vijim, kjo gjykatë nuk ka publikuar asnjë aktgjykim gjatë muajve maj, qershor dhe korrik. Kjo gjendje ka filluar të ndryshoj për të arritur numrin më të madh të publikimit të aktgjykimeve gjatë muajit tetor me 86 aktgjykime.




FIGURA 35. Pasqyra e gjyqtarëve me më shumë publikime në Gjykatën Themelore të Gjilanit

Se si kanë performuar degët e kësaj gjykate i shohim në tabelën e më poshtme.




FIGURA 36. Publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Gjilanit

Si gjykata po edhe degët kanë qenë shumë pasive sa i përket publikimit të aktgjyqimeve, diferencën e bënë dega e Novobërdës, e cila në total i ka publikuar 24 aktgjyqime.

Prej këtyre aktgjyqimeve, shumica janë aktgjyqime të natyrës penale , ndërsa pjesa tjetër janë të natyrës civile. Në tabelën e mëposhtëm mund të shihet pasqyrimi i këtij klasifikimi.

Tabela 9: Ndarja e aktgjyqimeve sipas natyrës së veprës.

Natyra e lëndëve	Penale	Civile
Gjykata Themelore e Gjilanit	188	33

Totali 221

TABELA 9: Ndarja e aktgjyqimeve sipas natyrës së veprës

Sa i përket zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Anonimizimin e Aktgjyqimeve, nga të gjitha aktgjyqimet e publikuara, vetëm 15 prej tyre kanë qenë të pa-anonizuara.

Zbatimi i Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjyqimeve nga kjo gjykatë është në nivel të kënaqshëm. Kjo në mënyrë skematike është paraqitur në grafikonin e mëposhtëm.




FIGURA 37. Përdorimi i Shabllonit në aktgjyqime

Gjatë periudhës monitoruese, kësaj Gjykate i janë dashur mesatarisht 180 ditë për publikimin e aktgjykimeve nga dita e shpalljes së tyre.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihni gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara nga kjo gjykatë.




FIGURA 38. Pasqyra e gjyqtarëve me më shumë publikime në Gjykatën Themelore të Gjilanit

REKOMANDIME

Bazuar në të gjeturat e këtij raporti monitorues, rekomandimet në vijim shihen si të domosdoshme për përmirësimin e ngecjeve në këtë fushë:

- 1** Këshilli Gjyqësor duhet të monitoroj Gjykatat e Kosovës mbi zbatimin e të gjitha rregulloreve dhe vendimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke përfshirë këtu edhe vendimin e KGJK për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve. Në të njëjtën kohë, KGJK duhet t'u kërkoj nga kryetarët e gjykatave që të raportojnë mbi arsyet e mos zbatimit të rregulloreve dhe vendimeve në fjalë. Nga monitorimi i Lëvizjes FOL del që ky vendim është aplikuar vetëm në 42% të aktgjykimeve të monitoruara.
- 2** Vendimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të cilat i obligojnë gjykatat për zbatimin e tyre, përveç që duhet të përcjellën përmes postes elektronike tek zyrtarët përgjegjës, njëkohësisht duhet të njoftohen që Vendimet dhe Rregulloret e tilla janë të publikuara edhe në ueb-portalin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Publikimi i Vendimeve dhe Rregulloreve që nuk janë publikuar në ueb-portal duhet të ndodh gjatë fazës së përditësimit të faqes dhe finalizimit të saj Gjatë punës sonë monitoruese dhe gjatë vizitave në terren, Lëvizja FOL ka vërejtur që ka një shkoputje sa i përket përcjellës së informatave në gjykata nga ana e Këshillit apo edhe nga personi përgjegjës për përcjelljen e informatave. Duke e përfshirë këtu edhe vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për përdorimin e Shabllonit Standard të Aktgjykimeve. Ashtu siç është paraqitur gjatë analizës, ky standard nuk është aplikuar në të gjitha gjykatat njëjtë.
- 3** Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të caktoj zyrtarë për informim në secilën gjykatë. Përveç që duhet secila gjykatë të ketë pozitë të plotësuar, gjykatat e ngarkuara me më shumë lëndë, duhet t'i kenë nga dy zyrtarë apo asistentë të zyrës. Sidomos në Gjykatën Themelore të Prishtinës si dhe asaj të Prizrenit. Ky rekomandim vlen vetëm në rastet nëse zyrtarët pvr informim veçse ushtrojnë edhe funksione tjera të cilat e bëjnë të domosdoshme shtimin e numrit të zyrtarëve. Procesi i publikimit të aktgjykimeve do të ishte më i lehtë nëse gjykata përkatëse do të kishte e zyrtarë të përcaktuar për këtë qëllim.
- 4** Gjykata Themelore e Mitrovicës, duhet t'iu siguroj kyçje në internet dy degëve të saj, Leposaviqit dhe Zubin Potokut. Publikimi i aktgjykimeve kërkon qasje domosdoshmërisht në internet. Po ashtu kjo gjykatë duhet të plotësoj pozitën e “Zyrtarit për Informim”, i cili ka rol të rëndësishëm/aprovues sa i përket publikimit të aktgjykimeve.
- 5** Të përditësohet ueb portali i KGJK me lajme ditore dhe me njoftime të rëndësishme për publikun. Gjatë periudhës monitoruese, Lëvizja FOL ka vërejtur se shpesh ueb portali nuk është përditësuar me lajme të reja, duke përfshirë këtu raportet statistikore, të cilat duhet të publikohen në ueb në baza mujore. Po ashtu vlen të theksohet që duhet të bëhet përditësimi i gjyqtarëve aktiv në gjykata (në shumë gjykata figurojnë gjyqtarët e pensionuar, gjyqtarët që kanë ndërruar gjykatë, apo edhe ata që kanë vdekur).
- 6** Ngritje të kapaciteteve për zyrtarët përgjegjës për publikimin e aktgjykimeve duhet të jetë prioritet. Gjatë vizitave tona në terren, ne kemi vërejte që zyrtarët përgjegjës për publikimin e aktgjykimeve

duhet të aftësohen edhe më tej, që përveç publikimit të tyre, t'i bëjnë publicitet punës së gjykatave përmes ueb portalit si dhe rrjeteve sociale.

- 7 Çdo aktgjykim i publikuar, duhet të kthehet në formatin PDF. Meqë ky është kriter i paraparë me Udhëzimin Administrativ për publikimin e Aktgjykimeve, gjykatat duhet ta respektojnë atë.
- 8 Çdo aktgjykim para publikimit duhet të rishikohet nga Zyrtarët për Informim sa i përket harmonizimit të aktgjykimit me Udhëzimin Administrativ për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve të Plotfuqishme. Siç e kemi theksuar më lartë, një numër i konsiderueshëm i aktgjykimeve është publikuar i pa-anonimizuar. Andaj ne kërkojmë nga zyrtarët përkatës që të rishikojnë aktgjykimin para publikimit.
- 9 Aktgjykimi para publikimit, duhet të shikohet se në cilën gjuhë është duke u publikuar, në mënyrë që të mos publikohet aktgjykimi i njëjtë në secilën gjuhë. Pasi që numri i publikimit të aktgjykimeve nuk pasqyrohet në mënyrë reale.
- 10 Unifikimi i numrit të rastit. Secili rast të ketë numrin e tij unik, jo ta ndaj me një rast të një natyre krejt tjetër. Gjatë monitorimit, Lëvizja FOL ka hasur në aktgjykime me numër identik të rastit, e të cilat në përmbajtje kanë qenë të ndryshme. Andaj, gjykatat duhet të kenë kujdes të shtuar sa i përket regjistrimit të rasteve duke mos përdorur numrin e njëjtë.
- 11 Të shënohen në të gjitha aktgjykimet parashtesat e numrave arkivorë që kanë për qëllim të tregojnë se për çfarë lënde bëhet fjalë (p.sh rast penal, civil etj). Nga monitorimi jonë, kemi vërejtur që nuk mund të identifikojmë një aktgjykim se cilës natyrë i takon vetëm nga numri i rastit. Andaj, kish me qenë mirë gjykatat ta praktikojnë që përveç numrit unik të rastit, të shtojnë edhe parashtesat, të cilat tregojnë se cilës natyrë i përkasin.

BURIMET

- 1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Prill 2008.
- 2 Këshilli i Evropës. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Tetor 2013.
- 3 Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Gjykatat. Dhjetor 2018.
- 4 Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Udhëzimi Administrativ (02/2016) për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjyqimeve të Plotfuqishme. Shkurt 2016.
- 5 Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Shabllonet Standarde të Aktgjyqimeve – Vëllimi I. 2018.
- 6 Intervistë me Arbër Jasharin, bashkëpunëtorë profesional/zyrtarë për informim në Gjykatën e Apelit. Realizimi i intervistës: 14.10.2019.
- 7 Intervistë me Mirlinda Gashin, zyrtare për informim në Gjykatën Themelore Prishtinë. Realizimi i intervistës: 24.10.2019.
- 8 Intervistë me Albënora Bekteshi – zyrtare për informim në Gjykatën Themelore të Ferizajt. Realizimi i intervistës: 15. 10 .2019.
- 9 Intervistë me Ahmet Buzolli – IT në Gjykatën Themelore të Mitrovicës. Realizimi i intervistës: I. II. 2019.
- 10 Intervistë me Afërdita Kicaj – zyrtare për informim në Gjykatën Themelore Prizren. Realizimi i intervistës: 23.10.2019.
- 11 Intervistë me Nëntor Oseku – bashkëpunëtor profesional në Gjykatën Themelore Gjakovë. Realizimi i intervistës: 28.10.2019.
- 12 Intervistë me Tringa Zhuti – Zyrtare për Informim dhe monitorim të mediave. Realizimi i intervistës: 28.10.2019

